



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201802575/12

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

Lënda : *Rekomandim për vlerësimin dhe argumentimin në mënyrë të drejtë e proporcionale të kërkesave të të dënuarve, me qëllim respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor*

**DREJTORISË SË PËRGGJITHSHME TË BURGJEVE**

**TIRANË**

**INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

**\*\*\***

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është administruar një ankesë nga shtetasi z. \*\*\*, i cili ankohet ndaj Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) \*\*\* për pengimin e të drejtës së tij të fituar gjyqësisht, lidhur me ndryshimin e masës së sigurisë, e drejtë e fituar në bazë të vendimit gjyqësor, sipas kërkesës së ankuesit.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se rasti plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore ndaj bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a,b , ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

**\*\*\***

***Rrethanat e rastit***

Ankuesi vuan dënimin pranë IEVP \*\*\*. Bazuar në nenin 13 të ligjit Nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" i ndryshuar, ai i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*<sup>1</sup>, për ndryshimin e klasifikimit të masës së sigurisë, nga siguri e lartë në siguri e zakonshme.

<sup>1</sup> Pasi në kohën e depozitimit të kërkesës ankuesi vuante dënimin pranë IEVP \*\*\*;

Në përfundim të procesit gjyqësor rezulton se me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*\*.\*\*.\*.\*\*\* Gjykata e Rrethit Gjyqësor \*\*\* ka vendosur pranimin e kërkesës dhe transferimin e ankuesit nga burg i sigurisë së lartë, në burg të sigurisë së zakonshme.

Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë nga I EVP \*\*\*. Për këtë fakt ankuesi i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, duke e konsideruar ankimin e ushtruar si cënim të të drejtës së tij të fituar gjyqësisht.

\*\*\*

### ***Baza ligjore e aplikueshme***

Të drejtat dhe trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente për garantimin e kushteve për trajtimin e personave të dënuar me burgim, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive të tyre themelore, rregullohen nga ligji nr.8328 datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar me ligjet nr. 8758, datë 26.3.2001; nr.9071, datë 22.5.2003; nr.9888, datë 10.3.2008; nr.10 087, datë 26.2.2009; nr.40/2014, datë 17.4.2014, dhe nr. Nr.108/2018, datë 20.12.2018.

Konkretisht, ndryshimi i klasifikimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale nga siguri e lartë në siguri të zakonshme, rregullohet nga dispozitat e neneve 13 dhe 72 të ligjit nr.8328 datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

Dispozita e nenit 13 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” i ndryshuar , përcakton se:

#### *Neni 13*

##### *Burgu i sigurisë së lartë*

*Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.*

*Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë në institucione të tjera të ekzekutimit të dënimit bëhet me kërkesë të prokurorit, të dënuarit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni. Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vetë të dënuarit, pranë gjykatës ku ndodhet institucioni.*

*Në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.*

*Në burgjet e kategorive të tjera me urdhër të Ministrit të Drejtësisë mund të krijohen seksione të burgut të sigurisë së lartë, në të cilat zbatohen rregullat e mësipërme.*

Dispozita e nenit 72 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” i ndryshuar , përcakton se:

Neni 72

Shqyrtimi i çështjes nga gjyqtari

*Gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm përse është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij. Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet.*

*Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj.*

\*\*\*

### ***Vlerësimi i institucionit të Avokatit të Popullit***

Për sqarimin e rrethanave të kësaj çështje, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar zyrtarisht IEVP \*\*\*, duke kërkuar shpjegime në lidhje me rastin e pozitën procedurale të këtij institucioni në procesin gjyqësor, si edhe vënien në dispozicion të një kopje të vendimit nr. 110, datë 27.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale \*\*\* në përgjigje të kërkesës sonë, pasi ka sqaruar rrethanat e rastit, është shprehur sa vijon:

*“ Në nenin 72 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, citohet: Gjyqtari shqyrton çështje dhe merr vendime vetëm përse është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrjen e detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij. Në këto procese ne jemi palë e interesuar, si palë e interesuar ishim për rrëzimin e kërkesës me objekt: transferim nga burg i sigurisë së lartë në burg të sigurisë së zakonshme. Nga ana jonë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë kundër vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor \*\*\*.”*

Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se IEVP e ka kufizuar përgjigjen vetëm në faktin se ky institucion ka ushtruar të drejtën e ankimit në pozitën e palës së interesuar duke qenë se ishte për rrëzimin e kërkesës, por nuk ka shpjeguar arsyet e këtij qëndrimi kundër vendimit të gjykatës për transferimin nga burg i sigurisë së lartë në burg të sigurisë së zakonshme, si edhe nuk ka përcjellë një kopje të ankimit të ushtruar, me qëllim që institucioni ynë të njihej me qëndrimin dhe argumentet e këtij institucioni, dhe proporcionalitetin e tyre në raport me kërkesën e personit dhe kushtet në të cilat ai ndodhej.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor \*\*\*, në vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*\* ndër të tjera thekson e arsyeton se:

*“ Në gjykim u provua se ky i dënuar aktualisht është duke vuajtur dënimin në burg të sigurisë së lartë, dhe se gjatë vlerësimit të sjelljes të bërë nga komisioni i I.E.V.P \*\*\* për në gjykatë për të dënuarin thuhet: gjatë qëndrimit në insitucion ka shfaqur sjellje pozitive për periudhën e fundit 2 (dy) vjeçare duke mos paraqitur rrezikshmëri shoqërore, nuk ka mbajtur dhe qarkulluar sende të palejueshme, nuk është ndëshkuar me masë disiplinore, nuk ka tentuar të largohet nga vendi i*

vuajtjes së dënimit, ka ndërtuar marrëdhënie pozitive me personelin e insitucionit, ka manifestuar sjellje pozitive me bashkëvuajtësit, takimet me familjarët i ka të rralla pavarësisht se thotë që marrëdhëniet me familjarët i ka të mira por për arsye ekonomike dhe largësie nuk mund t'a vizitojnë shpesh, ndjek ritet fetare të besimit katolik. Ka treguar korrektësi në kryerjen e detyrave, nuk shfaq sjellje stimuluese. Një fakt i tillë provohet nga vlerësimi i sjelljes së komisionit të I.E.V.P \*\*\* për në gjykatë.

Po kështu, i dënuari parashtrori në seancën gjyqësore duke thënë se arsyeja e transferimit nga burg i sigurisë së lartë në atë të zakonshëm është pasi unë jam i sëmurë, vuaj nga azma dhe jam me mjekime të vazhdueshme dhe se në burg të sigurisë së lartë nuk janë kushtet e përshtatshme për një të sëmurë i cili vuan nga azma. Nuk kam ajrosje të mjaftueshme që më nevojitet mua, gjithashtu kam dy prindër në moshë të vjetër; nuk jam i ndëshkuar me masë disiplinore.

Përfaqësuesi i I.E.V.P \*\*\* në seancë gjyqësore shfaqti mendimin duke thënë se i dënuari \*\*\* është dënuar me 25 vite burgim, në I.E.V.P tonë ka ardhur më datë 10.7.2018 dhe që nga ai moment ka patur sjellje pozitive, nuk ka shfaqur asnjë lloj tendence; nuk është i ndëshkuar me masë disiplinore për periudhën 2 vjeçare, por mendimi i komisionit është për rrëzimin e kërkesës për faktin se ka dhe shumë vite dënimi për të vuajtur.

...

Gjithashtu rezultoi e provuar sipas kartelës klinike nr. 2889 të shërbimit parësor në burgje se i dënuari \*\*\* vuan nga sëmundja e azmës.”

Siç rezultoi nga dispozita e nenit 72 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” i ndryshuar, pozita procedurale e përfaqësuesve të IEVP në procesin penal për shqyrtimin e kërkesave të personave të dënuar me heqje lirie është ajo e palës së tretë apo palës së interesuar.

Kjo pozitë procedurale e IEVP lidhet natyrshëm me vetë rolin e kontributin që ka institucioni në këtë proces, nisur nga fakti se është pikërisht kjo strukturë e cila monitoron sjelljen e personit përgjatë kohës dhe relaton për këtë çështje para gjykatës.

Megjithatë, e drejta e institucionit për të qënë palë në procesin gjyqësor e për të luajtur një rol proaktiv, nuk delegjtimon detyrimin që ka institucioni për të faktuar e argumentuar qëndrimin në mënyrë objektive e proporcionale, për të mundësuar zhvillimin e një procesi gjyqësor të paanshëm, të bazuar në parimin e kontradiktoritetit, ku secilës prej palëve u jepet mundësia të parashtrorin argumentet e provat e tyre dhe gjykatës i jepet mundësia të konkludojë në një vendimmarje sa më të drejtë.

Në këtë optikë, institucioni ynë vlerëson se pretendimi i ankuesit se IEVP nuk ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit gjyqësor nuk gjendet i bazuar, pasi pozita procedurale e palëve në një proces gjyqësor imponon të drejta dhe detyrime të njëjta për të gjitha palët.

Por, nga ana tjetër vlerësojmë se ka nevojë për ndërhyrje në lidhje me mënyrën se si juristët/punonjësit e IEVP e realizojnë efektivisht parashtrimin e argumenteve para gjykatës, për t'i krijuar asaj hapësirën e nevojshme për të krijuar bindjen e brendshme që

do të mundësojë marrjen e një vendimi në respektim të të drejtave të personit që e ka vënë atë në lëvizje.

Konkretisht, në rastin objekt ankimi që ka vendosur në lëvizje institucionin tonë, evidentohen rrethanat e mëposhtme:

*Së pari*, lidhur me rrethanat shëndetësore. Sipas të dhënave të kartelës klinike të shërbimit parësor në burgje rezulton se i dënuari vuan nga sëmundja e azmës, problematikë shëndetësore e cila e vështirëson jetesën e tij në kushtet e institucionit të sigurisë së lartë, fakt të cilin e ka relatuar edhe vetë kërkuesi si një prej shkaqeve kryesore të kërkesës për transferimin nga IEVP e sigurisë së lartë në një IEVP të sigurisë së zakonshme.

Kujdesi shëndetësor për personat më heqje lirie është një çështje me rëndësi të veçantë. Të burgosurit dhe të paraburgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore të tyre. Të burgosurit kanë të drejtën për të njëjtin nivel të kujdesit shëndetësor si personat që jetojnë të lirë në shoqëri. Respektimi i të drejtës për të gëzuar jetë dhe shëndet të plotë i personave që vuajnë dënimin me heqje lirie është një ndër të drejtat e tyre themelore, dhe rrethanë cilësuese e cila ndikon në të drejtën që ka personi për të kërkuar sigurimin e kushteve minimale për të vuajtur dënimin në një ambient që nuk përkeqëson gjendjen e tij shëndetësore.

*Së dyti*, siç rezulton nga përmbajtja e vetë vendimit të gjykatës, Komisioni i ngritur nga IEVP \*\*\* për të vlerësuar në tërësi sjelljen e kërkuesit, e ka vlerësuar këtë të fundit pozitivisht duke mos evidentuar asnjë element në sjelljen apo personalitetin e ankuesit që mund të përbënte shkak për mospranimin e kërkesës së këtij të fundit.

Nga ana tjetër, sipas përfaqësuesit të IEVP \*\*\* në procesin gjyqësor, pavarësisht se pohohet fakti se i dënuari ka shfaqur sjellje pozitive dhe nuk është ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore përgjatë periudhës 2 vjeçare të vuajtjes së dënimit, kërkohet rrëzimi i kërkesës nisur nga fakti se ai ka edhe shumë vite dënimi për të vuajtur.

Në lidhje me këtë qëndrim, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se qasja e organeve shtetërore dhe e përfaqësuesve të tyre në drejtim të të drejtave të personave që vuajnë dënimet me heqje lirie në këto struktura duhet të jetë në proporcion me rrethanat e diktuar, dhe të mos çënojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Për të arritur këtë qëllim, ligji ka përcaktuar disa kritere objektive mbi të cilat duhet të bazohen institucionet kur vlerësojnë dhe shprehen mbi kërkesat e personave për ndryshimin e nivelit të sigurisë, të tilla si gjendja shëndetësore, sjellja, takimet me familjarët, pendesa ndaj veprës penale që ai ka kryer, angazhimi me punë gjatë vuajtjes së dënimit, etj.

Qëndrimi i përfaqësuesit të IEVP \*\*\* në rastin konkret nuk provohet të jetë në proporcion me rrethanat e diktuar. Ankuesi nuk karakterizohet nga sjellje që të tregojnë se ai nuk mund të qëndrojë në një burg të sigurisë së zakonshme si edhe ka probleme shëndetësore të cilat e vështirësojnë jetesën e tij në një institucion të sigurisë së lartë. Këto rrethana nuk janë në raport të drejtë proporcional me argumentin e përfaqësuesit të IEVP \*\*\* që lidhet me kohën e mbetur të dënimit.

Kërkesa për ndryshimin e nivelit të sigurisë së institucionit ku kërkuesi vuan dënimin nuk lidhet me periudhën e mbetur të dënimit, por me vendin e vuajtjes së dënimit. Transferimi i kërkuesit në një burg të sigurisë së zakonshme në këtë rast do të ndikojë jo vetëm në

mundësinë e tij për t'u riintegruar në shoqëri e për të pasur kontakte më të shpeshta me familjarët, por edhe në gjendjen e tij shëndetësore.

Për më tepër, në bazë të institutit të vlerësimit të sjelljes së të dënuarit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, ligjvënësi ka krijuar hapësirën e nevojshme për transferimin e të dënuarit nga siguri e zakonshme në siguri të lartë në rastet kur ai shfaq sjellje të rrezikshme. Kjo do të thotë se ndryshimi i nivelit të sigurisë së institucionit ku i dënuari vuan dënimin nuk është përfundimtar dhe i përvokueshëm.

Sa më lart, vlerësojmë se qëndrimi që mban institucioni në gjykatë duhet të reflektojë dukshëm qasjen e respektimit të parimit të proporcionalitetit për të arritur qëllimin e kërkuar pa cënuar të drejtat dhe liritë themelore të personave që vuajnë dënimin me heqje lirie.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

### **REKOMANDOJMË:**

*Marrjen e masave për të siguruar rritjen e performancës së stafit të IEVP-ve, për të vlerësuar dhe argumentuar drejtë e në mënyrë proporcionale me rrethanat e diktuara, kërkesat e personave të cilët vuajnë dënimin me heqje lirie, me qëllim respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor;*

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, lutemi na ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar.

*Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.*

*Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,*

**KOMISIONERI**

**ERMONELA RUSPI**